

V E N D I M
Nr.32, datë 15.1.1993

**PËR RRITJEN E PËRKRAHJES SOCIALE PËR PERSONAT QË DALIN TË PAPUNË NGA
ZBATIMI I REFORMËS EKONOMIKE**

Me propozimin e Ministrisë së Punës, të Emigracionit, përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Personave që trajtohen me përkrahje sociale gjer më 31.1.1993, u rritet pagesa për përkrahje sociale në masën 18 për qind mbi atë ekzistuese.
2. Paga minimale mujore për efekt të llogaritjes së përkrahjes sociale dhe të ndihmës shoqërore bëhet 990 lekë.
3. Ministrisë së Punës, të Emigracionit, përkrahjes Sociale dhe të Përndjekurve Politikë, për përballimin e këtyre pagesave në planin e buxhetit për vitin 1993, i shtohet një fond prej 600 milionë lekësh.

Ky vendim hyn në fuqi më 1 shkurt 1993.

ZV.KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Bashkim Kopliku